



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

HARTA RRUGORE E ASK-së PËR VITIN 2018

Dhjetor, 2017
Prishtinë

PARATHËNIE

Ky dokument përmban planin e veprimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) dhe është i bazuar në Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2018 të ASK-së, si dhe në Programin e Statistikave Zyrtare 2018-2022, i cili është dërguar në Qeverinë e Kosovës për aprovim.

Në vitin 2018, ASK-ja do të jetë e përqendruar në: zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022; zbatimin e Programit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2018;; hartimin dhe zbatimin e Planit të Veprimir për realizimin e rekomandimeve të Raportit “Peer Review 2017”; avancimin e sistemit të planifikimit dhe të monitorimit përmes Sistemit të SIPK-ut; zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore, të rregulloreve ekzistuese dhe ato që priten të aprovohen; ngritjen e kapaciteteve në ASK, posaçërisht në statistikatat ekonomike, sociale, në TI dhe në mbledhjen e të dhënave.

Në këtë dokument janë paraqitur aktivitetet më të rëndësishme të ASK-së, që janë të bazuara në planet dhe detyrat e rregullta, të paraqitura në formë të proceseve rrugore të integruara. Përderisa, planet më të detajuara* ekzistojnë në dokumentet e brendshme të departamenteve përkatëse të ASK-së.

Në pjesën e parë të vitit 2018, sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta përgatisë një Raport Vjetor, ku do të përfshihet performanca e departamenteve, respektivisht arritjet në ASK dhe në Sistemin Statistikor të Kosovës. Dallimet eventuale, ndërmjet asaj që është planifikuar dhe asaj që është realizuar, barten si pjesë e planit për vitin vijues. Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare të Kosovës, Raporti Vjetor dërgohet në Qeveri dhe në Kuvendin e Kosovës për miratim.

* Planet e detajuara nënkuptojnë dokumentet, që i kanë departamentet përkatëse, të cilat cilësohen si “fletë punuese”.

PËRMBAJTJE

Faqe

1. ORGANIZIMI I ASK-së.....	4
1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2018.....	5
2. KËSHILLI STATISTIKOR	5
3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2018	6
3.1. Departamenti i Administratës.....	6
3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim	7
3.3. Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve	8
3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare	9
3.5. Departamenti i Statistikave Sociale dhe të Popullsisë.....	13
3.6. Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.....	16
3.7 Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative	20
4. FUSHAT E MBËSHTETURA NGA DONATORË.....	23
5. SFIDAT.....	25
6. SHPËRNDARJA E TË DHËNAVE & dhe QASJA.....	25
7. BUXHETI	30
Aneksi 1 - Organogrami i ASK-së.....	31

1. ORGANIZIMI I ASK-së

Me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të sakta, të besueshme, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarëshit, ASK-ja gjatë vitit 2018 do të rrisë kapacitetet njerëzore dhe profesionale, Kjo do të ndikojë pozitivisht në rritjen e performancës dhe përbushjes së vizionit dhe misionit të ASK-së. Përpjekjet për zbatimin e plotë të legjislacionit për prodhimin e statistikave zyrtare kanë vazhduar dhe do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2018. Ngritja e kapaciteteve njerëzore ndërlidhet edhe me obligimet e marra sipas nenit 95 të MSA-së, zbatimin e obligimeve nga ERA, si dhe zbatimin e detyrimeve nga PKZMSA-së.

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare (pritet që institucionet e Kosovës gjatë vitit 2017 dhe në fillim të viti 2018 ta aprovojnë plotësim-ndryshimet e këtij Ligji), Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, MSA-së, PKZMSA, ERA etj, para ASK-së janë shtruar detyra dhe përgjegjësi të mëdha në ngritjen edhe zhvillimin e statistikave zyrtare në nivel vendi, në harmoni me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare statistikore.

Prandaj, si rezultat i Ligjit të lartcekur, MSA-së, Raporti të “Peer Review 2017”, Rekomandimeve të KS, ASK-ja ka përgjegjësi të çartë në prodhimin e statistikave zyrtare. ASK-ja është përgjegjëse edhe për çështje të tjera, që parashihen me Ligj dhe me aktet nënligjore.

Prandaj, gjatë vitit 2018 ASK-ja planifikon:

- Përcaktimin dhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe përdorimin e standardeve për prodhimin e statistikave zyrtare. Për të gjitha publikimet, e dala nga ASK-ja, do të zbatohen të gjitha metodologjitë dhe standardet e statistikave evropiane;
- Ta paraqesë për miratim Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Raportin Vjetor 2017 mbi zbatimin e planit, programit dhe shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Raporti vjetor i miratuar do të publikohet;
- Fuqizimin e bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, kompetente për statistikave zyrtare, me qëllim që të mundësohet krahasimi i statistikave zyrtare të Kosovës me statistikave të prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Do të rritet përfitimi nga bashkëpunimi statistikor me organizatat ndërkombëtare me pjesëmarrjen e stafit të ASK-së në takime, punëtori dhe seminare;
- Të vazhdojë me organizimin e takimeve të Këshillit Statistikor, etj.
- Rritjen e koordinimit dhe komunikimit në kuadër të Sistemit Statistikor të Kosovës

1.1 Aktivitete të rëndësishme, që priten të finalizohen në 2018

- Rritja e kapaciteteve profesionale në ASK (njerëzore dhe infrastrukturore) dhe fuqizimi i statistikave ekonomike dhe sistemeve të TI.
- Mbështetje e avancuar e Teknologjisë Informativë (TI) departamenteve të statistikave prodhuese në të gjitha format: planifikim, digjitalizimi i grumbullimit të të dhënave, deponimi, përpunimi, analiza dhe shpërndarja inovative e të dhënave.
- Prodhimi i statistikave sipas standardeve evropiane dhe botërore dhe zgjerimi i volumit të tyre. Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare, zbatimimi i metodologjisë statistikore evropiane.
- Avancimi i zbatimit të Kornizës së Vlerësimit të Performancës (Projekti i SIPK-ut).
- Avancimi i vazhdimësisë së prodhimit të statistikave tremujore të BPV-së dhe statistikave tremujore të Tregut të Punës.
- Sigurimi/rritja i/e buxhetit të nevojshëm nga buxheti i Kosovës, përmes procesit të planifikimit të buxhetit për vitin 2019.
- Zbatimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Statistikave Zyrtare, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe hyrjes në fuqi

2. KËSHILLI STATISTIKOR

Pas skadimit të mandatit të Këshillit Statistikor, ASK-ja do të finalizoj të gjitha aktivitetet që në bazë të nryshimeve ligjore të statistikave zyrtare të formoj Këshillin e ri statistikor. Sipas këtij ndryshimi Këshilli i ri do të përbëhet nga katërmëdhjetë (14) anëtarë dhe Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, që përfaqësojnë ministrinë kyçe, Bankën Qendrore, Administratën Tatimore, universitetet, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile, siç janë cekuar më poshtë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
- Ministria e Shëndetësisë,
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,
- Ministria e Financave,
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës,
- Universiteti i Prishtinës,
- Administrata Tatimore e Kosovës,

- Zyra e Planifikimit Strategjik pranë Zyrës së Kryeministrit,
- Aleanca Kosovare e Bizneseve,
- Instituti për Menaxhimin e Ndërmarrjeve dhe Inxhinieri (IMNI) dhe
- Dy institucione joqeveritare kërkimore dhe shoqata biznesore

Këshilli Statistikor, ashtu siç ka vepruar deri më tash, do të jep rekomandime mbi përgatitjen dhe realizimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022, Planeve Vjetore, si dhe mbi zhvillimin dhe funksionimin e gjithmbarshëm të ASK-së, respektivisht Sistemit Statistikor të Kosovës.

Këshilli i ri do të themelohet me Vendim të Kryeministrit dhe do të funksionojë në mbështetje të Rregullores së ndryshuar dhe miratuar, sipas ndryshimeve të Ligjit për Statistika Zyrtare. Këshilli Statistikor do të dërgoj Raportin e vet në Qeverinë e Kosovës.

3. ZHVILLIMI I DEPARTAMENTEVE SIPAS PLANIT VJETOR 2018

Një ndër qëllimet e ASK-së është ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve profesionale sipas standardeve dhe metodologjive të kërkuara nga Eurostati. Ky zhvillim i departamenteve do të bëhet në pajtim me planin zhvillimor të ASK-së si dhe politikave të diseminimit për: evitimin e të gjitha gabimeve të mundshme në publikimet e ASK-së; zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive dhe teknologjisë statistikore; zhvillimin e politikave të standardizimit dhe mbështetjen në përvojat e fituara me ekspertë ndërkombëtarë për zbatimin e këtyre standardeve.

ASK-ja, në kuadër të këtij zhvillimi, do të ofrojë ndihmë profesionale për interpretimin e saktë të të dhënave zyrtare statistikore.

ASK-ja do të ketë për bazë edhe detyrimet e cekura më lartë, në dokumentet e rëndësishme siq është, Raporti Peer Review 2017, MSA, ERA, PKZMSA, etj.

Më poshtë janë dhënë zhvillimet e parapara sipas departamenteve për vitin 2018.

3.1. Departamenti i Administratës

Departamenti i Administratës është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative ditore në ASK, si: operacione financiare, kontabilitet, prokurim, rekrutime, gjegjësisht procedura, administrim i personelit (vijueshmëria në punë, largime, dosje personale, etj.), furnizime, logjistikë, etj. Shprehur me fjalë të tjera, përgatitja e pasqyrave financiare, raporteve mujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore; shërbime të personelit, duke mbuluar mirëqenien, rekrutimin dhe menaxhimin e burimeve njerëzore; prokurimin dhe shërbimet për menaxhimin e

kontratave (menaxhimi i aseteve, pronës dhe shërbimet e logjistikës). Në kuadër të Departamentit të Administratës janë të angazhuar një drejtor dhe 12 zyrtarë për vitin 2018.

Një prej pikave kyçe do të jetë zbatimi i Planit të Punës 2018, si dhe respektimi i të gjitha procedurave, gjegjësisht legjislacionit në fuqi, në funksion të menaxhimit të aktiviteteve të lartëcekura.

3.2. Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim

Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim (DPPKK) është themeluar në bazë të Rregullores për Riorganizimin e ASK-së.. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit janë të përshkruara në Rregulloren për Riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK). Në bazë të kësaj DPPKK është përgjegjës për planifikimin në ASK, për përmirësimin e bashkëpunimit (me institucionet vendore dhe ndërkombëtare), koordinimin (brenda ASK-së dhe Sistemit Statistikor të Kosovës), zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushën e statistikave, si dhe komunikimin me përdoruesit e statistikave zyrtare. Po ashtu, ky departament ka rol qendror në monitorimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022 dhe Planeve Vjetore, në këtë rast Planin Vjetor 2018.

DPPKK-ja ofron këshilla në kuadrin e zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare në fushën e statistikave për ASK-në dhe Sistemin Statistikor të Kosovës, si dhe për palët e tjera të interesuara sipas nevojës. Sigurimi i informacioneve (të dhënave analitike) të Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së lidhur me performancën e departamenteve prodhuese dhe mbështetëse në ASK është një nga detyrat parësore të këtij departamenti. Në këtë kontekst, edhe gjatë vitit 2018, do të hartohen raporte analitike për departamentet prodhuese përmes të dhënave nga sistemi i SIPK-ut dhe burimet e tjera mbi bazën e të cilave do të krijohet një pasqyrë e përgjithshme për top menaxhmentin e ASK-së, për vendimmarrje, bazuar në evidencë (shënime). Disa nga pikat (projektet/aktivitetet) më të rëndësishme të cilat priten të realizohen nga DPPKK për vitin 2018 janë si në vijim: hartimi i planit vjetor të Punës Vjetor 2019, monitorimi i zbatimit të Programit të dytë i statistikave zyrtare 2018-2022, mbështetja e zbatimi të Planit të Veprimit për realizimin e rekomandimeve nga “Peer Review 2017”, etj. Po ashtu të gjitha kërkesat (sigurimi i të dhënave) qoftë në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm si rezultat i proceseve të integritetit evropian. Mbështetja e plotë për zbatimin e rolit koordinues të ASK-së në kuadrin e Sistemit Statistikor të Kosovës.

Krijimi i një sistemi dialogues me shfrytëzuesit e të dhënave zyrtare në mënyrë që të adresohen kërkesat e shfrytëzuesve nga pikëpamja e cilësisë dhe vëllimit të të dhënave statistikore do të jetë pjesë e planit të DPPKK-së gjatë vitit 2018 dhe në të ardhmen.

3.3. Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve

Departamenti i Regjistrimeve dhe Anketimeve (DRA) është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave përmes anketave ekonomike, sociale, bujqësore, si dhe mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave të tjera që kërkohen nga ASK-ja. Ky departament do të angazhohet në ngritjen e cilësisë gjatë mbledhjes së të dhënave.

DAR ka nën menaxhimin e vet shtatë (7) Zyrrat Rajonale të ASK-së. Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve do ta ketë rolin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së aktiviteteve operative të Zyrrave Rajonale të ASK-së lidhur me mbledhjen e të dhënave në terren.

Ky departament në aspektin e organizimit ka pësuar disa ndryshime të vogla, ku të gjithë udhëheqësit e Zyrrave Rajonale raportojnë drejtpërdrejt te Drejtori i DAR-it.

DAR gjatë periudhes 2018 -2022 do të fillojë mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave me mjete dhe pajisje të TI-së, ku si mjete do përdoren Tabletët dhe Lloptopet me aplikacionet dhe programet moderne, ku të dhënat do shkarkohen direkt në bazat e shënimeve në Serverët e ASK-së. Qëllimi kryesor është zhvillimi, cilësia dhe shkurtimi i kohës së përpunimit të të dhënave nga departamentet prodhuese.

Përdorimi i këtyre pajisjeve teknologjike në mbledhjen e të dhënave nga terreni dhe grumbullimi në ASK, do të rrisë ekonomizimin dhe produktivitetin, si në sasi ashtu edhe në cilësi, që është edhe synim i ASK-së që të arrihen praktikat më të mira dhe kriteret me vendet e BE-së (EUROSTAT-it).

Gjatë vitit 2018 do të vazhdojë të bëjë harmonizimin e metodave për grumbullimin e të dhënave përmes anketave, si dhe do ta shtojë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e punëve gjatë realizimit të anketave të planifikuara nga departamentet prodhuese të ASK-së.

Po ashtu, do të ofrojë bashkëpunim me departamentet e tjera të ASK që të rrisë monitorimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen edhe ndaj operatoreve ekonomik, të cilët janë kontraktues të punëve në mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave, me qëllim të ngritjes së kualitetit të të dhënave statistikore, duke ju ofruar edhe ndihmë profesionale gjatë kryerjes së punëve në teren.

Për realizimin e punëve sipas kriterëve dhe dinamikës së paraparë në Planin dhe Programin e ASK-së, departamenti do t'i përgatisë raportet kualitative mbi ecurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për vitin 2018.

3.4. Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare

Sipas strukturës organizative aktuale të ASK-së, departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare përbëhet nga tri divizione: Divizioni i Llogarive Kombëtare, Divizioni i Statistikave të Çmimeve dhe Divizioni i Ndërmarrjeve dhe Statistikave të Tregtisë së Jashtme.

Sipas planifikimeve përfshi edhe ato buxhetore, gjatë vitit 2018 nga ky departament do të krijohen dy departamente, Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Departamenti i Llogarive Kombëtare.

Në planin e vitit 2018, në bazë të resurseve në dispozicion, departamenti ka këto prioritete: shkurtrimin e afatit të publikimit të të gjitha publikimeve (mujore, tremujore dhe vjetore); fillimin e publikimeve të reja tremujore, transmetimin e të dhënave në Eurostat (shtimin e numrit të tabelave) si Llogaritë Qeveritare; përmirësimin e metodologjisë së përpilimit të Llogarive Kombëtare në baza vjetore, sipas ESA 2010 dhe SNA 2008; organizimin e anketave për matjen e ekonomisë jo formale në katër aktivitete, përmirësimin e cilësisë së Regjistrit të Bizneseve; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të turizmit; përmirësimin e statistikave afatshkurtra të transportit; përmirësimin e statistikave të çmimeve; vazhdimi i detyrave të pilot-projektet e IPA 2015 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse, si dhe perfundimi i detyrave të pilot-projektet e IPA 2014 (MB) me projektet e veçanta të fushave përkatëse; asistenca teknike e FMN-së për Statistikat e Financave Qeveritare.

Më poshtë është lista e publikimeve të pritura në Departamentin e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare në vitin 2018.

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Statistikat e tregtisë së Jashtme	Dhj 2017	Jan 2018	Shk 2018	Mar 2018	Prill 2018	Maj 2018 & 2017 vj	Qer 2018	Kor 2018	Gush 2018	Sht 2018	Tet 2018	Nën 2018
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit	Dhj 2017	Jan 2018	Shk 2018	Mar 2018	Prill 2018	Maj 2018 & 2017 vj	Qer 2018	Kor 2018	Gush 2018	Sht 2018	Tet 2018	Nën 2018
Statistikat e Hotelarisë			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018			TM3 /2018
Indeksi i çmimit të importit			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018			TM3 /2018
Bilanci i Energjisë në Kosovë		TM4 /2017			TM1 /2018	2017/ vjetore		TM2 /2018			TM/ 2018	
Indeksi i çmimeve të prodhimit			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018			TM3 /2018
Rep. stat mbi ndërmarrjet në Kosovë	TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018			TM3 /2018		
Statistikat e Transportit	TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018			TM3 /2018		
Llogaritë Qeveritare				TM4 /2017		TM1 /2018 & 2017 vj			TM2 /2018			TM3 /2018
Bruto produkti vendor BVP-Qasja e Shpenzimeve & Prodhimit									2017			
Rezultatet e Anketës Strukturore te												2017

ndërmarrjeve											
BVP tremujore-Qasja e shpenz. dhe prodhimit				TM4 /2017		TM1 /2018			TM2 /2018		TM3 /2018
Indeksi i Kostos se Ndërtimit			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018		TM3 /2018
Statistikat tremujore per Industri			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018		TM3 /2018
Statistikat tremujore per Tregti me pakice			TM4 /2017			TM1 /2018			TM2 /2018		TM3 /2018
Rezultatet e Anketës se PRODCOM-it*											2017

Vëreni se muaji i shkruar në kutinë e hijezuar paraqet muajin/vitin e raportuar, përderisa muaji në krye të tabelës është muaji në të cilin publikimet priten të shpërndahen.

Gjatë vitit 2018 planifikohen të realizohen këto aktivitete, sa i përket statistikave makroekonomike.

a) Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2017:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-qershor 2018;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj -shtator 2018;
- Përgatitja e të dhënave përfundimtare për BPV, shtator 2018;
- Publikimi i të dhënave, dhjetor 2018.

b) Anketa për Azhurnimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve 2017:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), shkurt-tetor 2018;
- Kontrolli Logjik, kodimi, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill -dhjetor 2018.

c) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM4 2017:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2018;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2018;
- Publikimi i të dhënave, mars 2018.

d) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM1 2018:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2018;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2018;
- Publikimi i të dhënave, qershor 2018.

e) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM2 2018:

- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2018;
- Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik -shtator 2018;

- Publikimi i të dhënave, shtator 2018.
- f) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Industri, TM3 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2018.
- g) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM4 2017:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar - shkurt 2018;
- h) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM1 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2018;
- i) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM2 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2018;
- j) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Ndërtim, TM3 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2018;
- k) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM4 2017:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, shkurt-mars 2018;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2018.
- l) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM1 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill -maj 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, maj-qershor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2018.
- m) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM2 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, gusht-shtator 2018;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2018.
- n) Anketa Tremujore e Ndërmarrjeve për Tregti me Pakicë, TM3 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, nëntor-dhjetor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2018.

- o) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM4 2017:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar -shkurt 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, janar -mars 2018;
 - Publikimi i të dhënave, mars 2018.
- p) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM1 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), prill-maj 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-qershor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, qershor 2018.
- q) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM2 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), korrik-gusht 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, korrik-shtator 2018;
 - Publikimi i të dhënave, shtator 2018.
- r) Anketa për Çmimet e Kostos së Ndërtimit, TM3 2018:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), tetor-nëntor 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, tetor-dhjetor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2018.
- s) Anketa e PRODCOM-it 2017:**
- Anketimi i ndërmarrjeve të zgjedhura (mostra), janar-mars 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, prill-dhjetor 2018;
 - Publikimi i të dhënave, dhjetor 2018.
- t) Anketa Konsumi i Energjisë Elektrike në sektorët ekomomike (shërbimet dhe transporti)**
- Anketimi i ne teren, prill-qershor 2018;
 - Kontrolli Logjik, Përfshirja, Përpunimi dhe Analiza e të dhënave, qershor - korrik 2018;
 - Publikimi i të dhënave, bëhet në kuadër të balancës së energjisë, shtator 2018.
- u) Pilot-Projektet e IPA 2015 (MB)* - Programi i bashkëpunimit statistikor me shumë përfitues IPA 2015:**

- Statistikat e financave qeveritare GFS/EDP)
- Metodologjia e Llogarive Kombëtare (NAM);
- Programi i transmetimit ne Eurostat i dhënave të Llogarive kombëtare vjetore, tremujore dhe raportimi i kualitetit
- Llogaritë sektoriale
- Tabelat ofruese-perdoruese dhe Input- Output(SUT/IOT)
- Pariteti i Fuqisë Blerëse;
- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit;
- Regjistri Statistikor i Biznesit;
- Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve; implementimi i udhëzuesve dhe standardeve te Sistemit Evropian te Statistikave (ESS);
- Statistikat e Transportit- statistikat e transportit te udhëtarëve dhe te mallrave;
- Statistikat e Energjise;
- Identifikimi i burimit të të dhënave për kalkulimin e treguesve për sistemet e pa barazimeve makroekonomike.

/* Dinamika e realizimit të pilot-projekteve të IPA 2015 do të jetë sipas kontratës së nënshkruar. Të gjitha pilot projektet pritet do të përfundojnë në fillim të pjesës së dytë të vitit 2019.

3.5. Departamenti i Statistikave Sociale dhe të Popullsisë

Në kuadër të Departamentit të Statistikave Sociale (DSS), janë dy divizione: Divizioni i Statistikave Sociale dhe Divizioni i Statistikave të Popullsisë. DSS është përgjegjës për prodhimin e statistikave sociale dhe statistikave të popullsisë.

Departamenti i Statistikave Sociale do të vazhdojë me nxjerrjen e publikimeve të rregullta sipas Kalendarit të Publikimeve 2018, ndërsa prioritetet e DSS-së për vitin 2018 janë:

- Përgatitjet për **“Regjistrimin të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021”** sipas rekomandimeve ndërkombëtare për regjistrime dhe nevojave te vendit për nxjerrjen e indikatorëve socio-ekonomik. Gjate vitit 2018 përveç përgatitjes se Hartës rrugore/planit për regjistrimin e popullsisë do te draftohet edhe Ligji për regjistrimin e popullsisë si deh dokumentet tjera te rëndësishme.
- Finalizimi i **“Regjistrimit të popullsisë”** do të filloj nga mesi i vitit 2018 në një kohëzgjatje të planifikuar deri me 2021.

- Vazhdimi i grumbullimit dhe publikimit të rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore në baza tremujore duke shkurtuar kohën në më pak se 90 ditë si dhe publikimi i raporti vjetor;
- Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) nuk do të zhvillohet në vitin 2018 (tutje do të realizohet çdo katër vite), derisa indikatorët e rëndësishëm nga kjo anketë do të jenë pjesë e hulumtimit të ri të rekomanduar nga Eurostatit “Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës SAKJ apo e njohur si EU-SILC.
- Për herë të parë ASK-ja do të aplikojë grumbullimin e të dhënave përmes tabletave në anketën e SAKJ.
- Në kuadër të implementimit të grumbullimit të të dhënave me anë të tabletave tek anketa e SILC-ut, ASK-ja për herë të parë do të zhvillojë trajnimet e duhura për stafin e saj në hartimin e “Pyetësorëve Elektronik” në platformën “Survey Solution”, që do të shërbej për hulumtimet tjera, përfshirë edhe regjistrimet: popullsisë dhe bujqësisë.
- Anketa për “Përdorimin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit” (PTIK) në ekonomitë familjare është zhvilluar për herë të parë. Kjo ankete është e harmonizuar me standardet dhe metodologjitë e Eurostatit dhe do të vazhdojë të zhvillohet edhe në vitet tjera si anketë e rregullt.
- Pas ngritjes së bazës së shënimeve apo Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA-MASHT), grumbullimi i të dhënave të Statistikave të Arsimit bëhet përmes këtij sistemi duke ia mundur ASK-së largimin e grumbullimit të të dhënave përmes pyetësorëve manual. Ndërsa, për të dhënat e arsimit të lartë dhe tek komuniteti serb edhe në vitin 2018 ASK-ja do të vazhdojë të grumbullojë të dhënat derisa të jetë funksional Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë (SMIAL). Gjatë vitit 2018 do të finalizohet draft dokumenti i Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit ISCED 2011.
- Prioritet në statistikat vitale (lindjet, vdekjet, kurorëzimet, shkurorëzimet) është që grumbullimi i të dhënave të bëhet në formë elektronike nga bazat ekzistuese në institucione tjera relevante (ARC, IKSPKH, MPB dhe Gjykatat Themelore të Kosovës). ASK-ja do të zhvillojë diskutime gjatë vitit 2018 me institucionet e cekura për harmonizimin e bazave, gjithë përfshirja si dhe qasja në bazat e këtyre institucioneve. Nxjerrja i indekseve gjinore, vlerësimi i popullsisë si dhe hulumtimet tjera demografike.
- Të vazhdoj Publikimi i Statistikave të Jurisprudencës për personat e mitur dhe madhor, të filloj implementimi i Klasifikimi Standard Ndërkombëtar të Krimeve.
- Do të vazhdoj publikimi i të dhënave të Shëndetësisë, Mirëqenies Sociale, Kulturës dhe Sportit.

Lista e publikimeve nga Departamenti i Statistikave Sociale në vitin 2018

Muaji i botimit	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Rezultatet e Anketës mbi përdorimin e teknologjisë informative dhe të komunikimit 2017	2017											
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare						2017						
Anketa e Fuqisë Punëtore			TM4 2017	2017		TM1 2018			TM2 2018			TM3 2018
Statistikat e Jurisprudencës për personat të mitur						2016						
Statistikat e Jurisprudencës për personat të madhor									2017			
Statistikat e Arsimit						2017/2018						
Statistikat e Kulturës										2017		
Statistikat e Mirëqenies Sociale				2017								
Statistikat e Shëndetësisë											2017	
Statistikat e Sportit												2017
Statistikat e Lindjeve						2017						
Statistikat e Vdekjeve						2017						
Statistikat e Kurorëzimeve							2017					
Statistikat e Shkurorëzimeve							2017					
Statistikat për shkaqet e vdekjeve										2014/ 2015		
Vlerësimi i popullsisë						2017						
Statistikat Gjinore												2016/ 2017

Publikimet e planifikuara nga Departamenti i Statistikave Sociale në vitin 2018 janë:

- Publikimi i rezultateve të Anketës mbi përdorimin e teknologjisë informative 2017;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM4 2017;
- Publikimi i rezultateve vjetore të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2017;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM1 2018;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM2 2018;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për TM3 2018;
- Publikimi i rezultateve të Anketës së Buxhetit dhe Ekonomive Familjare (ABEF) 2017;
- Publikimi i Statistikave të Arsimit 2017/2018;
- Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale 2017;
- Publikimi i Statistikave të Jurisprudencës për Personat e Mitur 2017;
- Publikimi i Statistikave të Jurisprudencës për Personat Madhorë 2017;
- Publikimi i Statistikave të Shëndetësisë 2017;
- Publikimi i Statistikave të Kulturës 2017;

- Publikimi i Statistikave të Sportit 2017;
- Vlerësimi i Popullsisë 2017;
- Statistikat e Lindjeve 2017;
- Statistikat e Vdekjeve 2017;
- Statistikat e Kurorëzimeve 2017;
- Statistikat e Shkurorëzimeve 2017;
- Statistikat për Shkaqet e Vdekjeve 2014/2015;
- Statistikat Gjinore 2016/2017.

Aktivitetet e tjera

- Realizimi i Anketës mbi Shëndetin
- Zhvillimi i Anketës mbi Koston e punës
- Pilot projekti i IPA 2015 për Anketën e Fuqisë punëtore
- Pilot projekti i IPA 2015 për Anketën TIK,
- Pilot projekti i IPA 2015 për Statistikat e Krimeve,
- Pilot projekti i IPA 2015 për Anketën SILC.
